

## Ndryshimet në legjislacion

Tetor 2016

### Në këtë publikim:

- Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2016 Për Përcaktimin e Procedurës së Digjitalizimit të Regjistrave Themeltarë të Skanuar të Gjendjes Civile;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2016 Për Pajisjen me Letërnjoftim, Pasaportë dhe Patentë Shofer me Procedurë të Përsheptuar;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2016 Për Shkatërrimin e Autorizuar të Dokumenteve Publike dhe Shkresave Zyrtare;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2016 Për Mënyrën e Themelimit, Funkionimit, dhe Administrimit të Inkubatorëve të Biznesit;



#### **I. Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2016 Për Përcaktimin e Procedurës së Digjitalizimit të Regjistrave Themeltarë të Skanuar të Gjendjes Civile**

Me 7 tetor 2016, Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës (MPB) ka lëshuar Udhëzimin Administrativ (UA) Nr. 12/2016 për përcaktimin e procedurave së digjitalizimit të regjistrave themeltarë të skanuar të gjendjes civile. Baza ligjore për këtë Udhëzim Administrativ është Ligji Nr. 003 mbi Gjendjen Civile.

Ky Udhëzim Administrativ përcakton procedurat për digjitalizimin e regjistrave themeltar të skanuar të gjendjes civile për krijimin e Arkivit Elektronik të Regjistrave Themeltar të Gjendjes Civile.

Neni 4 I këtij Udhëzimi Administrativ, liston llojin e informatave të cilat do të digjitalizohen nga çdo regjistër përkatës, p.sh Regjistri i Lindjes, Regjistri I martesës dhe Regjistri i vdekjes. UA i tanishëm nuk mbulon digjitalizimin e të dhënave nga regjistra tjerë mirëpo siguron që mënyra për digjitalizimin nga regjistra tjerë do të rregullohet me një akt të veçantë nga Drejtori I Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC).

Organi kompetent për implementimin e këtij udhëzimi administrative është Agjencia e Regjistrimit Civil pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

#### **II. Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2016 Për Paisjen me Letërnjoftim, Pasaportë dhe Patentë Shofer me Procedurë të Përsheptuar**

Ministria e Punëve të Brendshme ka lëshuar Udhëzimin Administrativ No.13/2016 për

Pajisjen me Letërnjoftim, Pasaportë dhe Patentë Shofer me Procedurë të përshpejtuar, i cili u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 13 tetor 2016.

Ky Udhëzim Administrativ rregullon procedurën për pajisjen me letërnjoftim, pasaportë dhe patentë shoferë me procedure të përshpejtuar në Republikën e Kosovës.

Sa i përket këtij Udhëzimi Administrativ, procedura për marrjen e dokumenteve të lartpërmendura me procedure të përshpejtuar do të përfundohet brenda 72 orëve nga momenti I aplikimit pranë Qendrës për Pajisje me Dokumente (QDP).

Kjo periudhë kohore nuk llogaritet si në vijim:

- Nga ora 16:00 të premtën deri në orën 8:00 të hënën, dhe
- Nga ora 16:00 e ditës së fundit të punës para festës zyrtare deri në ora 8:00 të ditës së parë të punës pas festës zyrtare.

Gjithashtu janë disa kategori që mund të pajisjen me këto dokumente me procedure të përshpejtuar pa paguar tarifë shtesë.

Në të gjitha rastet tërheqja e dokumentacionit do të bëhet pranë QDP-së në Prishtinë.

QDP-ja do të mbajë evidence të veçantë për të gjitha dokumentet e lëshuara me procedure të përshpejtuar.

Ky Udhëzim Administrativ është nënshkruar më datë 12 tetor dhe do të hyj në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet Udhëzim Administrativ Nr. 22/2011 për Pajisjen me Letërnjoftim, Pasaportë dhe Patentë Shofer me procedure të Përshpejtuar.

### **III. Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2016 Për shkatërrimin e Autorizuar të Dokumenteve Publike dhe Shkresave Zyrtare**

Ministria e Punëve të Brendshme nxori Udhëzimin Administrativ Nr. 14/2016 Për Shkatërrimin E Autorizuar Të Dokumenteve Publike Dhe Shkresave Zyrtare, i cili u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datën 13 Tetor, 2016.

Baza ligjore për nxjerrjen e këtij Udhëzimi Administrativ është Ligji Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim.

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurave të shkatërrimit të dokumenteve publike, si dhe shkresave zyrtare.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme do të marr vendimin për themelimin e Komisionit për Shkatërrimin e Dokumenteve, i cili komision do t përbëhet nga 5 anëtarë. Vendimet e Komisionit merren me shumicë të thjeshtë të votave.

Të gjitha dokumentet që shkatërrohen duhet të regjistrohen në bazën elektronike. Baza e dokumenteve të shkatërruara duhet të jetë e vendosur në një hapësirë me siguri të lart dhe të i nënshtrohet procedurave standarde të ruajtjes së bazave të shënimeve të "Back-up"-it.

Ky Udhëzim Administrativ u nënshkrua më datën 12 Tetor dhe do të hyj në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit.

### **IV. Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2016 Për Menyrën e Themelimit, Funkzionimit, dhe Administrimit të Inkubatorve të Biznesit;**

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nxori Udhëzimin Nr. 15/2016 Për Mënyrën E Themelimit, Funkzionimit Dhe Administrimit Të Inkubatorëve Të Biznesit, i cili u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datën 18 Tetor, 2016.

Baza ligjore për këtë Udhëzim Administrativ është Ligji Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike.

Ky Udhëzim Administrativ rregullon procedurat e themelimit, funksionimit dhe administrimit të Inkubatorëve të Biznesit. Një Inkubator i Biznesit nënkupton një ndërtesë/object që ofron ambient fizik dhe ambiente biznesi për ndërmarrësit e rinj dhe të atyre të cilët në mungesë të hapësirës nuk mund të zgjerojnë kapacitetet e tyre, të cilët mund të krijohen në kuadër të Zonave Ekonomike dhe jashtë tyre.

Qëllimi i Inkubatorit të Biznesit është:

- Mbështetja e bizneseve fillestare – ideve të reja për biznes;
- Nxitja dhe inkurajimi i ndërmarrësve potencial për biznes;
- Hapja e vendeve të reja të punës;
- Zgjerimi i bashkëpunimit në mes bizneseve fillestare;

Inkubatorët e Biznesit mund të iniciohen nga Qeveria e Kosovës në bazë të propozimit të Ministrisë, nga Komuna brenda territorit

administrative dhe në kuadër të kompetencave të tyre dhe nga Partneriteti Publiko-Privat (PPP) sipas legjislacionit përkatës.

Ky Udhëzim Administrativ ka hyrë në fuqi 7 ditë nga nënshkrimi i tij dhe ka shfuqizon Udhëzimin Administrativ Nr. 17/2013 për Mënyrën e Themelimit dhe Funkcionimit të Inkubatorëve të Biznesit.

## **Kontaktet e Deloitte:**

### **Afrore Rudi**

Drejtoreshë | Shërbime të Taksave dhe Ligjore

Deloitte Kosova sh.p.k.

Rr. Ali Hadri n.n., 10000

Prishtinë, Republika e Kosovës

Cel: +386 (0)49 590 807

E-mail: [arudi@deloittece.com](mailto:arudi@deloittece.com)

### **Luljeta Plakolli - Kasumi**

Menaxhere | Shërbime Ligjore

Deloitte Kosova sh.p.k.

Rr. Ali Hadri n.n., 10000

Prishtinë, Republika e Kosovës

Cel: +386 (0)49 780 769

E-mail: [lplakollikasumi@deloittece.com](mailto:lplakollikasumi@deloittece.com)

## **Përrjashtim i përgjegjësisë:**

Ky publikim përmban vetëm informacion të përgjithshëm dhe asnjëra nga firmat anëtare apo filialet e Deloitte Deloitte Touché Tohmatsu Limited (së bashku referohen si "Deloitte Network") përmes këtij publikimi ofrojnë këshilla apo shërbime profesionale për kontabilitet, biznes, financiare, investime, ligjore, tatimore apo këshilla dhe shërbime tjera profesionale.

Ky publikim nuk është zëvendësim i shërbimit apo këshillës profesionale, dhe nuk duhet të përdorur për të marr ndonjë vendim që mund të i ndikonte financat e biznesit tuaj. Para se të merrni ndonjë vendim apo veprim që do të mund të ndikonte në financat e biznesit tuaj, ju duhet të konsultoheni me një këshilltar profesional dhe të kualifikuar. Asnjë entitet i rrjetit të Deloitte nuk do të konsiderohet përgjegjës për ndonjë humbje të pësuar duke u bazuar në këtë publikim.

\*\*\*

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touché Tohmatsu Limited, një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë dhe firmave të saj anëtare. Secila nga këto firma përfaqëson një entitet ligjor të ndare dhe të pavarur. Përshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të organizatës Deloitte Touché Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën [www.deloitte.al/about](http://www.deloitte.al/about).

Deloitte ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulencë dhe konsulencë financiare klientëve si privat dhe publik në të gjitha industritë që ata operojnë. Në sajë të një rrjeti të lidhur ndërkombëtar të firmave anëtare në më shumë se 150 vende, Deloitte sjell mundësi të klasit të parë botëror dhe shërbime me kualitet të lartë për klientët, duke dhënë njohuritë tek ata që i adresojnë sfidat më komplekse. Pothuajse 244,400 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etaloni i përsosmërisë.

© 2016 Deloitte Kosova sh.p.k